



## Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



### PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 19.06.2018, me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të përshëndes, Nënkryetarin Fatmir Iska, delegatët e pranishëm në këtë seancë të KPF-së, monitoruesit e KFORIT, OSBE-së, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Kuvorur për mbajtjen e mbledhjeve ka, ju paraqes rendin e ditës të parapare për këtë mbledhje.

### REND DITE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar,
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Rahovecit 2019 – 2021,
3. Shqyrtimi i Planit të Veprimit Komunal Kundër Korrupsionit,
4. Shqyrtimi i Raportit të Performancës Komunale,
5. Shqyrtimi i propozim Vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm pjesën e parcelës P-71513005-00524-4, në fshatin Krushë e Madhe
6. Shqyrtimi i propozim Vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm pjesën e parcelës P-71510056-00034-0, në fshatin Opterushë,
7. Shqyrtimi i propozim Vendimit për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokalë,
8. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndihmë financiare z. Bajram Popaj,
9. Të ndryshme.

**Kryesuesi**- E qesim në votim rendin e ditës, konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

#### 1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar

A ka dikush të shtojë diçka rreth procesverbalit? Nëse jo e qes në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

#### 2. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Rahovecit 2019 – 2021,

Për këtë pikë ftoj drejtorin e financave z. Afrim Limani.

**Afrim Limani**- Përshëndetje për ju Kryesues dhe të gjithë të pranishmit, më datën 16.05.2018 në adresën e Komunës së Rahovecit ka ardhur qarkorja e parë buxhetore ku është përcaktuar edhe risku do të thotë pjesa e mjeteve financiare, pjesa e buxhetit për Komunën e Rahovecit për vitin 2019. Në bazë të qarkores buxhetore ne si Qeveri Komunale kemi përgatitur Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) duke ju dhënë prioritet disa sektorëve në veçanti ekonomisë, arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe shërbimeve publike, buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2019 sipas qarkores së parë është në total 13,490,277€ ku grandit i përgjithshëm është

5,231,000€, këshilli i Hoqës së Madhe është 23,494 €, grandi i shëndetësisë 1,686.240€, i arsimit 5,380.480€, harrova të them të hyrat vetanake janë 1,168.767€ që në total buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2019 është 13,490.277€ nëse e bëjmë një krahasim në raport me vitin e kaluar buxheti i Komunës sonë është më i vogël për 39,530€ si rezultat i zvogëlimit të hyrave vetanake në shumën prej 481,260€, grandi i përgjithshëm ka një rritje prej 458,589€ gjë që është shumë pozitive ndërsa e mira e kësaj është edhe zvogëlimi i të hyrave vetanake në shumën prej 481,000€ tash realisht nëse e marrim një aspekt që pse e them se është mirë është sepse Komuna e Rahovecit asnjëherë nuk ka mundur të inkasojë të hyrat vetanake në bazë të direktivave të cilat na kanë ardhur nga ministria e financave, besoj që shuma prej 1,168.000€ është reale dhe nëse angazhohemi bashkë është shumë të cilën mund ta arrijmë. Ne si drejtori e financave në bazë të këtij buxheti përafërsisht kemi përcaktuar edhe limitet dhe shpërndarjen e mjeteve financiare në kategori të ndryshme, kjo është qarkorja e parë buxhetore dhe qarkorja e dytë mund të devijojë, por devijimet mund të jenë shumë të vogla, atëherë në bazë të kësaj qarkoreje pozicioni i pagave do të ketë shumën prej 7,391.000€, mallra dhe shërbime 1,409.000€, shërbime komunal 255.000€, subvencione 196.000€, investime kapitale 4,405.000€ do të thotë përafërsisht do të jenë këto limite të shohim edhe qarkoren e dytë buxhetore, unë do të ju shpjegoj edhe në përqindje, ndikimi i përqindjes në total të buxhetit sipas kategorive ekonomike. Pagat kanë një përqindje prej 53,93%, mallra dhe shërbime bashkë me komunal 12,43%, subvencione 1,76%, investime kapitale në masën prej 32,09%, sa për sqarim unë për fund do të ju them që në këtë KAB është bërë një gabim teknik në faqen tetë tek grandi qeveritar figuron shuma 11,321.000€ kjo do të thotë nuk është 11,321.000€ por 12,321.000€ kërkoj falje për këtë gabim teknik, ju faleminderit.

**Florije Boshnjaku**- Përshëndetje për të gjithë, sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Rahovecit edhe unë po mundohem të jap sado pak një kontribut të vogël në bazë të përvojës, drejtor unë nuk e di që na ka ardhur qarkorja e parë buxhetore është mirë nëse ke mundësi të na sillet dhe ta kemi secili anëtar i Kuvendit sepse shumica nuk kemi shumë njohuri është mirë ta kemi qarkoren dhe ta shohim, ajo që dua të cek është tek faqja numër 1 – analiza gjinore sepse nuk pashë ndonjë prioritet ose projekt propozim për barazi gjinore, tek faqja numër 3 në pjesën e parë aty ku është Komuna e Rahovecit mendoj se duhet të rishikohet sepse janë 33 fshatra dhe qyteti i Rahovecit, vendbanime nuk ka se e kam cekur edhe më herët vendbanimet ndahen në qytete dhe fshatra edhe qyteti ndahet në lagje urbane është mirë të shikohet ligji mbi kufijtë administrativ dhe ta përmirësojmë pasi që është një dokument zyrtar, pak më poshtë ceket se administrata e Komunës është e vendosur në një ndërtesë, a mund ti bëjmë dy ndërtesa pasi i kemi këtu dy ndërtesa, tek mirëqenia sociale nuk pashë asnjë pikë ku ceket ofrimi i shërbimeve sociale, është mirë të ceket ofrimi i shërbimeve sociale në mënyrë të barabartë, ju faleminderit.

**Fabrije Lushi- Morina** – I nderuar Kryesues, të nderuar kolegë këshilltarë dhe ju të pranishëm, tek Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Rahovecit, tek strategjia zhvillimore komunale, deklarata e prioritetëve afatmesme për tri vitet e ardhshme 2019-2021 unë mendoj se më tepër është një analizë ose përmbledhje e cila thjeshtë mendojmë dhe shpresojmë të gjithë se duhet të realizohet, mirëpo do të ndalem tek disa pika të cilat unë kam dhënë disa mendime ose thjeshtë kam edhe prioritetet e renditura siç i keni renditur edhe ju drejtor. Në njëfarë mënyre brenda kësaj Kornize Afatmesme Buxhetore (KAB) është vendosur një pasqyrë më e detajuar nga ana juaj duke dhënë një plan i cili sjell më hollësisht strategjinë e drejtorisë përkatëse se si i kanë renditur prioritetet që sipas të cilave mund të arrihet një punë të cilën jo vetëm drejtorja për buxhet dhe financa mirëpo të gjithë ne do të e dëshironim, por në ç'formë keni mbështetur këto prioritete besoj që jo vetëm mua por të gjithëve do të na nevojitet gjatë kohë që të mbledhim e të shohim më tepër fakte të argumentuara më tepër sesa kjo pasqyrë e cila me të vërtetë është përpiluar në disa pika mjaft të qëndrueshme, por që në vijim mbetet të përcjellim këto qëndrime që keni nisur tani, domethënë duhet gjatë kohë ti kemi parasysh ose edhe ti analizojmë këto që ju i keni renditur, dua të ndërlihem këtu edhe tek subvencionimi i fermerëve meqë ishim tek kjo problematikë e që mjaft shqetësuese janë faktet që lidhen me këtë pikë sepse këtu do të kërkoj një sqarim shtesë dhe që besoj se është në interes të gjithë qytetarëve tanë, nëse qeveria vendos të i mbështesë bujqit ose fermerët tanë duke i ndihmuar në sanimin e gjendjes së tanishme, çka do të ndodhë me subvencionet a do ju jepen veçmas edhe ato apo do të përmbillet kjo vetëm me një mbështetje të gjendjes së tanishme? Këtu dua të shtoj edhe për të ardhmen d.m.th këto shqetësime i ngris edhe tek KAB që e keni bërë vetë ju i nderuar drejtor, edhe për periudhën në vijim siç është thënë këtu d.m.th vitet 2019-2021 a do të i përcjellë bujqit tanë kjo situatë që i shqetëroi në këtë vit, mirëpo a mendoni se

do të ndërmermi edhe hapa të tjerë pos këtyre fakteve që ju i keni renditur këtu d.m.th duke thënë që do të i subvencionojmë, do të rregullojmë kanale të ujitjeve e të gjitha këto, pra unë e mbështes dhe e pëlqej këtë Kornizë Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Rahovecit mirëpo dua sqarim se si do i bëni këto prioritete dhe sa do të realizohen sepse më intereson shumë të di meqë i kemi bujqit dhe fermerët në një gjendje të cilën e përjetojmë të gjithë së bashku, pastaj tek infrastruktura në sektorin e bujqësisë, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore, ndërtimi i kanaleve të kullimit në zonat ku paraqiten vërshimet e shumë e shumë të tjera siç është zgjerimi i sistemit të ujitjes në zonat ku mungon edhe pse kësaj here gjithë qytetarët tanë kanë pësuar më tepër se kurdoherë, unë shpresoj që të gjitha këto plane dhe strategji që i keni hartuar me kaq përpikëri ta bëni vepër e cila vërtetë do të mbetet e fundit e hartuar si gjithmonë vetëm në fjalë e letër, sepse këtu me thënë drejtën flitet më tepër edhe për vitet në vijim sepse kjo është një çështje e ndjeshme dhe besoj në interes të gjithëve pa dallim, dua të vazhdoj edhe tek përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe rritja e cilësisë në arsim, sërish keni vendosur çështje më të ndjeshme sa i përket arsimit ku sipërfaqësisht këto i patëm paraprakisht edhe në informacionin e drejtorisë së arsimit, jo që më bezdis kjo dukuri e përsëritjes mirëpo gjithë këto që të kenë qëndrueshmëri na duhet bazë e saktësisë duke thënë që në këtë shkollë apo atë kemi arritur deri këtu, me këtë infrastrukturë apo atë funksionalizim të organeve dhe angazhim të shërbimeve adekuate të cilat i keni renditur edhe këtu gjithmonë flas për vitet në vijim sepse dua ta anashkaloj këtë vit se nuk kemi pasur ndonjë fakt ose argument si nga drejtori i arsimit po ashtu edhe nga ju në përgjithësi që të keni dhënë informacione ose gjithçka të detajuar sa i përket si infrastrukturës po ashtu edhe funksionalizimit, tek pika e 5 përmirësimi i ambientit, keni filluar nga përmirësimi dhe rigjenerimi i infrastrukturës rrugore e deri tek pyllëzimi që me të vërtetë i duhen Komunës dhe qytetarëve mirëpo na jepni pak më tepër detaje edhe gojarisht duke ju mbështetur në punët të cilat i keni filluar dhe cilat janë ato prioritete që me të vërtetë i keni filluar? D.m.th këtu unë mendoj që të jepen detaje edhe për këtë vit sepse është një periudhë 6 mujore ku thjeshtë ani pse ky është një Kornizë Afatmesme Buxhetore për vitet në vijim mirëpo kërkoj detaje edhe për këtë periudhë 6 mujore, cilat janë ato prioritete që me të vërtetë i keni filluar duke përmendur ndonjërin prej tyre sepse vetëm në bazë të dhënave faktike mund të krijohen bindjet nga të tjerët përndryshe plane gjithmonë mund të hartojmë madje edhe më superiore por në anën tjetër kur këto të parat mungojnë pak rëndësi mund të kenë këto prioritete që çdo herë mund të përsëriten, është edhe pika e 6 krijimi i Qeverisë Komonale që krijon shërbime efikase dhe që ju përgjigjet kërkesave të qytetarëve, nuk ka asnjë mangësi mënyra se si e keni përpiluar dhe e keni ndarë një qeverisje efikase për qytetarët mirëpo kjo më tepër mban një moto sesa diçka të tillë, unë uroj të ndodhin këto por gjithsesi çdo gjë që bëjmë pa e dëmtuar buxhetin sepse atëherë qytetarët nuk mund të përfitojnë pa i dëmtuar në anën tjetër përndryshe nga çdo aspekt kërkohet besoj veprime më efikase në mënyrë që edhe qytetarët të ndiejnë këtë efikasitet të punës tuaj dhe jo vetëm kaq, edhe tek të rinjtë, kultura dhe sporti në Komunën tonë unë uroj të gjitha të realizohen mirëpo dy pika që më bëjnë më tepër përshtypje janë: Intervenimi në monumentet kulturore-historike dhe mirëmbajtja e tyre si dhe pasurimi i fondit librar në bibliotekat e Komunës tonë sepse janë të një rëndësie të veçantë dhe kanë një karakter tipik të ruajtjes dhe zhvillimit kulturor të ruajtjes të një shoqërie apo në këtë rast të një lokaliteti përkatës, lokalitetit tonë, ju faleminderit.

**Florida Bajraktari-** Përshëndetje për të gjithë, unë desha të ndalem tek faqja me numër 3 ku thuhet se do të bëhet krijimi i zonave ekonomike dhe industriale, desha të bëj pyetje se a ka Komuna prona shoqërore për tu krijuar këto hapësira ekonomike? Ju faleminderit.

**Dervish Qadraku-** Përshëndetje për të gjithë, është e vërtetë se kjo Kornizë Afatmesme Buxhetore është në njëfarë mënyre objektiv në vija të trasha të veprimeve që duhet të i bëjë ose do t'i bëjë Komuna e Rahovecit dhe institucionet e saj deri në vitin 2021 por njëfarë mënyre është edhe një kopje sepse vit pas viti përsëriten këto gjëra bile mos të ma merr për të keq edhe drejtori por si ta them edhe ato veprimet ose llafet që i kanë bërë me elektoratin e vet ose premtimet që i kanë bërë pak a shumë janë të bartura këtu dhe gjithmonë kështu vit pas viti një pjesë e madhe e tyre nuk janë realizuar unë nuk do të zgjatem shumë për arsye se kemi edhe kritika pastaj pse po zgjateni po përsëriten gjërat por unë dua të them se si mund të shpjegohet ndërtimi i qendrave të reja shëndetësore kur i kemi qendra të reja shëndetësore të pa funksionalizuara, e kemi në Malësi të Vogël, Caritasi ka aktivizuar në njëfarë mënyre, e kemi edhe në Polluzhë më duket është e pa funksionalizuar, në qoftë se i shohim kështu në një gjeografi e shohim që është e mbuluar me objekte por nuk kemi njerëz që punojnë aty sepse ju e dini që edhe ligji mbi shëndetësinë e ka të definuar sa mjekë mund ti

mbulojnë sa mijë banorë, por hajt po e lëmë atë por ne pse si funksionalizojmë këto por i ndërtojmë të reja d.m.th kjo njëfarë mënyre është këto firmat që ndërtojnë e tash e shohin veten aty që tash do të kenë punë, është ajo qasja e partive që ne jemi për juve nuk ju lëmë pa punë e në fakt ne kemi krijuar objekte e nuk kemi njerëz ose nuk mund ti funksionalizojmë ato objekte, e kemi zgjerimin e administratës ju e dini mirë që ka qenë një aparaturë aty që ka ndihmuar shumë që të vihet rend në pritje aty tek sportelet kurse ajo nuk është funksionale, kurse ne kërkojmë një funksionalizim ose efikasitet përmes rritjes së sporteve e faktikisht ne i kemi aparaturat që i ka krejt bota edhe ato janë diku në ndonjë qoshe të Komunës andaj kjo mua nuk më pëlqen se e thashë edhe më herët është si një lloj fushate, pastaj u tha që nëpër shkolla do të ndikojmë tek parandalimi i veseve të këqija droga, duhani dhe alkooli, ju e dini që e kemi shumë të dobët cilësinë e arsimit çka mund të bëni ju ose ne si Komunë për parandalimin e drogave, duhanit edhe alkoolit kur faktikisht struktura e arsimit nuk është në terezi kjo është sikur një lloj parulle që kinse do të bëjmë diçka e në fakt as s'kemi bërë as s'do të mundemi të bëjmë, por kur të tjerët e lexojnë ndoshta mendojnë që njëmend do të bëhet diçka, pastaj ceket këtu se deri në vitin 2020 do të krijohen rreth 500-600 biznese të reja, pse nuk e kemi edhe pasqyrën edhe sa biznese janë shuar që janë mbyllur dhe pse janë mbyllur ato ne e dimë pse janë mbyllur sepse bizneset tona ose ekonomia jonë nuk po sheh perspektivë dhe njerëzit tanë po ikin, kanë ikur edhe të rinjtë ata që duhet të bëjnë biznes nuk janë këtu, ne që ndoshta edhe përtej Kosovës njihemi si Komunë e bujqësisë ne dje ose pardje mbajtëm një mbledhje emergjente për shkak të dëmeve që na ka bërë moti i keq në bujqësi d.m.th aty hyn sistemi kundër-breshër, i kemi lumenjtë e pakontrolluar këtu pashë intervenime në lumenj ne Lumin Drini i Bardhë na duhen 25 milionë € për ta vu në kontroll, por këta lumenj që kanë bërë dëme kaq të mëdha në Komunën tonë ne nuk kemi mundësi të i kontrollojmë ose nuk jemi duke i kontrolluar prandaj mendoj që kjo kornizë duhet ta ketë parasysh që këta lumenj duke filluar nga i pari ndoshta Dullo që e kemi edhe lumenj tjerë të i kontrollojmë dhe jo të krijojmë hinka ndoshta e kuptoni të i mbledhim ujërat kemi krijuar njëfarë hapësire, rrugë ose një lloj shtrati të lumit ndërsa pjesa tjetër poshtë është e pa hapur dhe e pamundur të kalojë uji dhe atë ka prona kontestuese atje poshtë ka probleme kontestimi megjithatë Komuna këtë punë ka që individit i cili përpiqet për interesin e tij personal ta bëjë interesin e përgjithshëm, të lëshojë rrugë ose ato uzurpime që i kanë bërë dhe mua ma merr mendja që investimi më i madh në bujqësi është kjo sesa që na jepen subvencione nuk po them që duhet të hiqen subvencionet por në qoftë se bujkut ja mundësojmë këtë punë që ai të mos ketë frikë nga prodhimet e tij që do të i humbasin, të mos ketë frikë nga reshjet dhe ujërat e rrjedhshëm atëherë hapim rrugë bujkut për prodhime, ne nuk kemi treg ju e dini në Ish-Jugosllavi tregu ka qenë deri në Lublanë, ne tregun e vetëm e kemi në Xërxe që shiten këto prodhime prandaj Komuna duhet të interesohet edhe për eksportimin e këtyre prodhimeve, ku mund ti dërgojmë këto prodhime dhe jo të vijë puna pastaj disa ti gjuajnë disa ti shesin me çmime të lira dhe është mirë që Komuna të merret edhe me këtë punë prandaj unë them që kjo Kornizë të merret me çështje shtyllë që njëfarë mënyre Komuna e Rahovecit është e varur prej saj d.m.th bujqësia, 600 biznese të bëhen të reja e faktikisht neve njerëzit po na ikin përditë, para nuk kemi, ju e keni parë çfarë të hyra kemi nga jashtë d.m.th remitencat i kemi rreth 700 milionë e kështu me radhë edhe ne bizneset tona kush i njih e dimë që qarkullimin më të madh e kemi atëherë kur vijnë njerëzit nga jashtë, hajde pra të bëjmë diçka me këta njerëz brenda që të prodhojnë dhe fitojnë që në pranverë të mos hyjnë borxh mos të hyjnë kredi për ta filluar punën e re. Ju faleminderit.

**Fehmi Cena** – Do të mundohem edhe unë që të japë kontributin tim, mendoj se KAB-i është një dokument bazë që do të shërbej në të ardhmen se si rrugëtim se si duhet që të punoj qeveria, si duhet që ta orientoj punën e saj dhe buxhetin e Komunës konform prioriteteve për një zhvillim sa më të mirë të Komunës dhe për një mirëqenie sa më të mirë të qytetarëve. Është një dokument gjithëpërfshirës besoj se është edhe një mostër edhe në nivel Kosove por që i përgjigjet Komunës. E kam lexuar me kujdes KAB-in e kam parë që janë të përfshirë të gjitha segmentet që janë të nevojshme me u përfshi, do të diskutoj sipas faqeve sepse në disa vende ka shumë material ku mundem të japë kontributin tim. Në faqe nr.3 ceket për biznese, mua më vije mirë që komuna jonë ka diku rreth 3000 biznese, kjo e tregon se është një gjendje e mirë, ku ceket se diku 16% prej tyre janë biznese të prodhimtarisë. Mendoj se kur është fjala për ndarje të subvencioneve qeveria qendrore më shumë duhet që të jepe prioritet bizneseve të prodhimtarisë, për arsye se bizneset e prodhimit janë bazë për zhvillimin e ekonomisë së vendit. Tek forcimi i ekonomisë formale u përmendë nga parafolësit krijimi i zonëve ekonomike industriale, mua ajo që më intereson është se a ka krijuar deri më tani Komuna jonë zonë ekonomike dhe industriale e cila i plotëson kushtet për zhvillim të bizneseve, nëse po atëherë kishte

me qenë mirë që të na informojë. Tek forcimi i sektorëve të bujqësisë, këtu janë të përqendruar më shumë subvencionet, thuhet tek perim - kulturë do të ketë subvencione për mekanizëm bujqësorë, kurse më poshtë e kemi të cekur sektorin e vreshtarisë dhe unë do e kisha shtuar edhe sektorin e pemëtarisë, mendoj se duhet që të ketë subvencionime edhe këtu në aspektin e mekanizmit bujqësorë. Në sektorin e vreshtarisë ceket: Inventarë për trajtim të rrushit pas vjeljes, kjo nënkupton se subvencionim do të ketë vetëm për ata që mirën me përpunimin e rrushit, por jo edhe vreshtarët që e kanë si lëndë të parë rrushin. Pastaj që nga viti 2019 ceket se bujqit do të paguajnë edhe tatimin në tokë dhe me këtë taksë bujqit do të kenë edhe një shpenzim shtesë, prandaj nëse ata kanë shpenzime shtesë ne duhet që ti ndajmë subvencione, pastaj 1.75% e subvencionimit nga niveli qendror për komunën tonë mendoj se është shumë pak, pse e them pak është sepse ne jemi vend bujqësor dhe shumica e ekonomive familjare nga komuna jonë të ardhurat e vetme i kanë nga bujqësia, njerëzit e komunës sonë e punojnë tokën, prandaj edhe ne duhet që të ata që i ndihmojnë atyre që e punojnë tokën. Në faqe nr. 4 nuk jam duke e parë pjesën që e përmendëm dje pjesën e emergjencave, pra ndarja e mjeteve për raste emergjente sikurse që e kemi tani rastin, në mbledhjen emergjente që e kemi pasur dje janë ndarë 7,000.00 € për raste emergjente, mendoj se janë shumë pak prandaj mendoj se Komuna duhet që të ketë më në fokus këtë pjesë. Situatat emergjente mundemi të i kemi çdo vit prandaj ne duhet të parapërgatitemi, nëse ne nuk i shfrytëzojmë ato të hodha për raste emergjente, që shpresoj të mos kemi fare ne mundemi që ti shfrytëzojmë pastaj për qëllime të tjera. Tek përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe rritja e cilësisë në arsim, ndërtimet e shkollave të reja, e njëjta gjë vlen edhe në shëndetësi, po ashtu edhe unë nuk jam që të ndërtohen shumë objekte qoftë shkolla apo ambulanca, me të vërtet kemi mjaftë ambulanca të cilat janë ndërtuar por nuk janë funksionalizuar për arsye se nuk janë mundësitë, ne duhet të dimë se objekti nuk ofron shërbime por shërbime ofron stafi profesional. Prandaj jam pro asaj që buxhetin qeveria komunale ta orientoj më tepër në mirëmbajtje dhe rindërtime, në rast se një shkollë është dëmtuar shumë atëherë ja vlen që të ndërtohet objekti i ri, por nëse nuk është dëmtuar shumë atëherë është mirë që të rindërtohen objektet. Tek shëndetësia ceket kujdesi paliativë është një kujdes shtëpiak për të sëmurë me sëmundje kronike, uroj që ne ta bëjmë një shërbim të tillë sepse ata kanë nevojë për këtë shërbim, në kuadër të kësaj kishte me qenë mirë që të futet edhe shërbimi për pleq me sëmundje kronike të rëndë të cilët janë të palëvizshëm. Pastaj në faqe nr.5 kemi përmirësimi i ambientit të Komunës që është diçka e mirë, pastaj zgjerimi i rrjetit të kanalizimit edhe këtu qeveria duhet që të punoj sepse është diçka me prioritet sikurse edhe rrjeti i ujit të pijes. Por ajo që na brengos është se ne jemi duke i rregulluar kanalizimet, por në anën tjetër jemi duke i ndotur ujërat sipërfaqësore, por e mirë së mirës do të ishte sikurse të vendosen impiantet e përpunimit të ujërave të zeza, mendoj se duhet që të punohet paralel edhe në zgjerimin e rrjetit të kanalizimit por edhe në ndërtimin e impianteve në mënyrë që të mbrohen ujërat. Pastaj shërbimet më efikase administrative si krijimi i sporteleve të veçanta për mërgatën, kjo pakës më ka vlarë syrin sepse nuk e di se sa është e nevojshme krijimi i sporteleve të veçanta për mërgatën, nuk e di a e kanë kërkuar ata apo ka ardhur nga dikush si ide. Nëse këto sportele që i kemi janë funksionale atëherë ato do të punojnë mirë edhe për mërgatën por edhe për ne, nuk është mirë që të krijohet kjo ndarje. Tek rinia, kultura dhe sporti ajo që më ka rënë në sy është krijimi i teatrit amatorë të qytetit, kjo është mesë e domosdoshme sepse sa e di qyteti i Rahovecit nuk e ka, duhet që të punohet në këtë drejtim dhe të shikohet se a duhet që ta formojmë një teatër të tillë për qytetin. Mendimi imë është se krijimi i këtij teatri do të jep një ngritje kulturës së artit si për rinin ashtu edhe për të gjithë qytetarët, pa e krijuar një teatër amator ne nuk mundemi të kemi kurrë një teatër profesional në të ardhmen. Disa tabela në fund nuk janë të plotësuar nuk e di pse, besoj se drejtori do të na tregoj arsyen pse janë lënë kështu.

**Rasim Fazliu** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kolegët i përmendën shumë gjëra që desha unë të i përmendi, e mbështes znj. Florije Boshnjaku për atë që tha se Komuna duhet të dijë se sa fshatra dhe vendbanime i ka Komuna e Rahovecit, do të ndalem të diskutoj më shumë rreth planifikimit të hyrave vetanake Komunale. Ne gjithmonë kemi planifikuar më shumë kurse me i realizu asnjëherë nuk kemi mundur, po ashtu kur është bërë analiza vjetore e buxhetit se çka kemi mundur me bë, kemi pasur vërejtje pse është bërë planifikimi pa vend, prandaj po e them se ky planifikim i të hyrave është real, por desha të ndërlihem meqenëse këtu ceket se në vitin 2018 planifikohet të bëhet edhe tatimi në toka dhe implementimi i taksës për mbeturina, mos të na vije puna pastaj që të themi se kemi planifikuar pak kurse kemi realizuar më tepër. Kishte me qenë shumë mirë që të hyrat vetanake të komunës sonë të ritën sepse ato janë në të mirën e qytetarëve, pastaj e kemi një pyetje për drejtorin: A keni bërë ndonjë kalkulim në bazë të asaj se kur të filloj

tatimi i tokave, sa do të jenë të rriturat vetanake dhe në bazë të kësaj mundet të bëhet edhe planifikimi. Nëse ndalemi tek sektori i bujqësisë, është cekur forcimi i sektorit të bujqësisë ku janë përfshirë shumë pika të cilat duhet përshëndetur, nëse i shikojmë si koreografi me të vërtet janë shumë të mira dhe shumë të qëlluara, por sa kemi mundësi buxhetore që të gjitha këto pika të sektorit të bujqësisë me i mbështet financiarisht. E dimë se bujqësia me të vërtet ka nevojë që të mbështet posaçërisht pasi ne edhe jemi trevë bujqësore, kishte me qenë mirë që të ndahen edhe më shumë mjete për sektorin e bujqësisë, por siç e tha edhe znj. Florije Boshnjaku këto mjete i ka kanalizuar ministria, por nëse mundet të gjinden mjetet për të i ndihmuar bujqësisë kishte me qenë shumë mirë sepse edhe me këtë është duke u bërë punësimi i njerëzve të komunës së Rahovecit, por nuk duhet që të anashkalohej edhe sektorët e tjerë si ato të rinisë, kulturës etj, pra gjitha sektorët është mirë që të ndihmohen. Nuk do e zgjasë më tepër pasi është qarkorja e parë buxhetore, kur të vije qarkorja e dytë atëherë do të kemi material dhe kohë më shumë për të diskutuar.

**Afrim Limani** – Do ju përgjigjem pyetjeve tuaja aq sa di dhe aq sa kam mundur që ti shkruaj. Pajtohem me kritikën e znj. Florije Boshnjaku që të përmirësohet në fillim numri i vendbanimeve, pastaj z. Dervish Çadraku e tha se është bërë kopi pastë, po është e vërtet që kam kopjuar por për këtë më vonë do i përgjigjem. Znj. Florije Boshnjaku e tha se qarkorja buxhetore kishte me qenë mirë që të na dërgohet, po ju them se me qëllim nuk ju kam dërguar sepse kam dashur që të kursej letrën, arsyeja është se qarkorja buxhetore është shumë e madhe dhe do të krijoheshin shumë shpenzime, por ju jeni ata që vendosni nëse dëshironi për kuvend do të ju sjellë. Sa i përket buxhetit për barazi gjinore të ju them të drejtën e kam ditur se znj. Florije do të më bëjë pyetje, prandaj edhe e kam analizuar shumë mirë këtë buxhet. Kjo është qarkorja e parë buxhetore dhe në qarkoren e parë buxhetore përafërsisht caktohet buxheti në vija të trasha, kurse në qarkoren e dytë buxhetore caktohen edhe limitet buxhetore dhe saktësisht p.sh. pozicioni i pagave është një shumë fikse që dihet, kurse shpenzimet rrjedhëse si mallra, shërbime dhe komunali është një limit ku caktohet se sa duhet të ketë dhe pjesa e mbetur është për investime kapitale, prandaj ka mbetur edhe pa u plotësuar pjesa e KAB-it për vitin 2019. Për barazinë gjinore jam marr ekskluzivisht me të dhe i kam autorizuar që të marrin shënime më të sakta për çdo drejtori se sa është numri i gjinisë femërore në mënyrë që me një analizë të saktë të shikojmë se sa është pjesëmarrja në buxhet e gjinisë femërore, por besoj se në KAB-in përfundimtar këto shënime kanë me qenë të cekura. Znj. Fahrije Lushi i bërë disa pyetje, por shqetësimi i juaj për subvencionim të fermerëve ju garantoj se këtë vit dhe viteve të tjera do të jetë shumë mirë sepse ne pretendojmë që buxhetin për bujqësi ta risim diku në 1 milion € e ndoshta edhe më shumë, besoj se me një buxhet prej 1 milion € të gjitha ato që janë në kuadër të drejtorisë së bujqësisë do të plotësohen. Fondi për emergjencë këtë vit e kemi pasur 10,000.00 €, por pas këtij rasti që na ndodhi besoj se ne së bashku me ju buxhetin për emergjencë do e risim. Znj. Florida Bajraktari pyeti a ka komuna zona ekonomike, për këtë besoj se përgjigje më të saktë do ju jep Nënkrjetari i Komunës, por e di që jemi duke pritur që shumë shpejtë dy zona do të kalojnë në pronësi të komunës, një pjesë është në fshatin Optrushë dhe tjetra sa e di në fshatin Drenocit. I nderuari z. Drevish Çadraku mundem të them se kopi pastë është diku 10-15%, për më shumë po të garantoj se nuk është sepse vetë kam punuar, ndërsa të gjitha shqetësimet e juaja që i ngrite në pjesën teorike ndoshta në kuvend mundesh që ti drejtoresh drejtorëve dhe besoj se ata do të japin përgjigje më të saktë. Ishte një pyetje pse janë shuar bizneset, kam një informatë se shumë biznese janë regjistruar vetëm pse kanë pasur një interes të vogël, si për aplikim për viza, për më shumë detaje ne mundemi që të kërkojmë argumente shtesë nga zyra për regjistrim të bizneseve. Doktor i bëri disa pyetje, besoj se në disa prej pyetjeve i kam dhënë përgjigje, pyetja ishte po ashtu pse nuk janë plotësuar tabelat, përgjigja ime është sepse presim qarkoren e dytë buxhetore dhe aty do të caktohen limitet ose tavanet buxhetore. Sa i përket pjesës së subvencioneve që ishte një pyetje, i nderuari z. Fehmi cena, ne edhe këtu i kemi limitet të cilat na i kufizon MF ku ajo na cakton një limit dhe mbi këtë shumë ne nuk mundemi të shkojmë, vetë unë në mandatin e kaluar kam kërkuar që të bëhet një presion në MF që të paktën kjo kategori të rritet, por nuk është marrë për bazë. Sa i përket premtimit që e thatë e ka bërë kryetari në fushata për bujqësi, duhet të bëni dallimin sepse 1 milionëshi është investim kapital në total, aty përfshihen edhe subvencionet, personalisht do të mundohem që të kemi një fleksibilitet më të madh ne si qeveri dhe ju si kuvend që të paktën këtë kategori të kemi mundësi me e ritë. Z. Rasim Fazliu pyeti për planifikimi i të hyrave vetanake, tatimi në toka, tatimi në mbeturina. Këtë vit i nderuar është shumë më mirë në krahasim me vitet e kaluara sepse MF e ka caktuar një limit që mendojmë është shumë real dhe besoj se do mundemi me e realizu planifikimin e të hyrave vetanake. Sa i përket tatimit në mbeturina mendoj që këtë vit do të jetë

problem që të realizohet sepse janë shumë pengesa në aspektin ligjor, por besoj se në vitin e ardhshëm për mbeturina i kemi të planifikuar 140,000.00 €. Kurse sa i përket tatimit në toka nuk kemi të planifikuar sepse është vit i sprovës dhe kjo mbetet pastaj që na bazë të analizave tona me e përfshi një planifikim, me falni për gabimin teknik sepse tatimi në toka do të filloj në vitin 2019 e jo siç është e cekur këtu në vitin 2018.

**Florije Boshnjaku** – U pajtova me z. Rasim Fazliun kur e tha se aty ku ecin burrat ecin edhe gratë, po ashtu u pajtova me parafolësit kur e thanë se duhet të fillojmë të mendojmë nëse kemi mjaftë shkolla dhe numri i nxënësve është duke u zvogëluar dhe a ka qeveria ndonjë ide tjetër. Edhe në qeverinë a kaluar kam propozuar që të ndërtohen çerdhet, nuk desha të cekim dhe të ju ngarkoj pasi është qarkorja e parë buxhetore, por kur të vijë qarkorja e dytë buxhetore duhet që të parashihet edhe ndërtimi i çerdheve sepse ky është interes i përgjithshëm i grave, gratë në çdo takim kanë kërkuar që të ndërtohen çerdhet, nuk mundet një grua të punoj nëse nuk ka ku ta dërgoj fëmijën. Pastaj të hyrat që janë paraparë për mbeturina për vitin 2019, ne nuk mundemi me i parapa të hyrat nëse nuk shpallim tender, pasi e fiton tenderin kompania X pastaj ja paguajmë operatorëve ekonomik, ku ai pastaj do të bëjë mbledhjen e mbeturinave, kurse komuna do të duhet që të mbledh këto të hyra, por jam e mendimit që në vitin 2019 do të jetë shumë vështirë që të mbledhen këto mjete, e kam cekë edhe në vitin 2017 por besoj se do të shkojë gjithçka në rregull. Po ashtu duhet që të bisedohet me drejtorin e DKA-së, për mbajtjen e mësimit jo formal dhe të parashihet si të hyrë vetanake të komunës, komunitat të tjera e kanë prandaj e them sepse nëse nuk është e paraparë në buxhet nuk ka mundësi askush që ti merë këto të hyra nëse nuk janë të paraparë me buxhet.

**Dervish Çadraku** – Desha vetëm ti them drejtorit se nuk e pata fjalën për materiale që i kanë bërë kopje, por ishte fjala për nevojat dhe kërkesat që janë të përsëritshme vit pas viti dhe në një farë mënyrë është bërë rutinë dhe vetëm në letra i qesim kurse gjysmën prej tyre nuk i realizojmë. Pastaj pyetje tjetër është se ku është aparatura e cila ka qenë tek sportelet, që shërbente për nxjerrje të numrave për pritje në rend të qytetarëve.

**Afrim Limani** – Së pari e marrë shumë pozitivisht si pyetjen e parë ashtu edhe të dytën, shpresojmë se buxheti për bujqësi të jetë 1 milion € dhe mendoj se duhet të jetë kaq, duke e ditur se 75% e njerëzve të komunës sonë mirën me bujqësi. Sa i përket asaj aparature që e përmendët, të ju them të drejtën nuk mundem me ju dhënë ndonjë përgjigje, mendoj se për këtë përgjigje më të saktë do ju jep drejtoresha e administratës. Sa i përket taksës së mbeturinave që i përmendi znj. Florije Boshnjaku, ngarkesa vitin e kaluar ka qenë

400,000.00 €, duke menduar se i kanë bërë disa parapërgatitje dhe kanë menduar që ja fillojnë, por nuk kanë mundur sepse së pari aty mungon infrastruktura ligjore, pastaj mungon stafi dhe ende nuk kemi një vendim që kemi të drejtë ndalesë të qytetarëve për mbeturina, mua personalisht MF më ka pyetur sa mendoni ju se do ti rriteni inkasimin nga të hyrat, por pa mare parasysh ne duhet që të fillojmë inkasimin e të hyrave me kushtet tona edhe pa zgjerim të stafit. Ne si model e kemi marrë Prizrenin ku ata ja kanë filluar me kapacitetet e veta, me realizim nuk ishin të kënaqur, po ashtu edhe me infrastrukturë nuk ishin të kënaqur, ne vitin e ardhshëm gjithsesi se duhet që të fillojmë në vitin e ardhshëm, nuk jam i sigurt por e di që 140 apo 160 mijë i kemi të planifikuar.

**Fehmi Cena** – Kishte me qenë mirë që të na shpjegoni se si do të sigurohen këto të hyra prej 140,000.00 €, tani ekziston një sistem i pagesës për mbeturina, çka do të ndryshoj nga ky sistem. Po ashtu pyetjen që e bërë më herët për buxhetin për emergjencë nuk jam duke e parë në këtë KAB se nga cili pozicion do të jetë.

**Afrim Limani** – Nuk jam juristë por mendoj se së pari duhet që të vijë ligji mbi të drejtën e ndalimit të qytetarëve ose kufizimin e të drejtës në nxirjen e një dokumenti, në mënyrë që të bëhet inkasimi i mjeteve. P.sh nëse vjen qytetari për ta nxjerrë një dokument dhe nga ai kërkohet vërtetimi i pagesës së mbeturinave nëse e ka i lëshohet dokumenti që e kërkon nëse jo atëherë ai detyrohet të paguaj mbeturinat. Sa i përket buxhetit për emergjencë këtë vit në kuadër të investimeve kapitale është një buxhet i ndarë për emergjencë me shumën prej 10,000.00 €. Më herët janë shpenzuar 3,000.00 € ndërsa kanë mbetur edhe 7,000.00 €, kurse për vitin 2019 ne së bashku me ju pretendojmë që këtë buxhet ta risim.

**Florije Boshnjaku** – Mendoj se mundem të ju ndihmoj sa i përket inkasimit të mbeturinave pasi kam qenë në disa trajnime, ashtu siç unë e kam kuptuar komuna tani e tutje në bazë të ligjit e ka për obligim që nga kodi i mallrave dhe shërbimeve të ndajë buxhet prej 400,000.00 €, pastaj komuna e shpallë tenderin e fiton operatori ekonomik dhe pastaj ky operator e pastron të gjithë qytetin dhe ai nuk merret më me inkasim të mjeteve, por komuna sikurse që e bënë inkasimin e tatimit në pronë ashtu e bënë edhe inkasimin e mbeturinave, prandaj ne së pari duhet që ta ndajmë buxhetin e pastaj komuna ja paguan operatorit, e mbetet te komuna pastaj se a

mundem që të realizoj pastaj të hyrat, por kjo është duke hasur shumë vështirësi në Kosovë. Por së pari ministria duhet që të ja risë buxhetin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, pastaj ne e ndajmë shumën prej 400,000.00 €. Kështu ne jemi trajnuar dhe kemi mësuar në trajnim, pastaj edhe në rregullore është e cekur kështu.

**Nënkryetari** – Përshëndetje për të gjithë të pranishëm, desha të ndërlihem rreth diskutimit të fundit, nga ministria janë përzgjedhur disa komuna sa i takon menaxhimin të mbeturinave, inkasimit të hyrave dhe në mesin e 6 komunave është edhe komuna e Rahovecit. Së pari duhet që të formohet një njësi e veçantë e cila do i trajtojë inkasimin e të hyrave, do të caktohen zyrtarë përgjegjës dhe inkasanti i cili do të jetë pjesë e komunës do të ketë një sportel të veçantë për pagesë të mbeturinave, kurse procedura tjetër është ashtu siç e ceku e nderuara znj. Florije Boshnjaku. Sido që të jetë besoj se në fund të vitit do të finalizohet kjo dhe do të përcaktohen zyrtarët përgjegjës për punën që duhet të bëjnë dhe qytetarët do e paguajnë mbeturinat aty për aty e jo të shkojnë inkasantë nëpër shtëpi siç është deri tani. Znj. Florida Bajraktari pyeti për zonë ekonomike dhe industriale, e nderuar është hapi i parë i kësaj qeverie dhe i çdo qeverie që nga pas lufta që ju janë drejtuar, por ato prona janë në menaxhim të agjensionit të pyjeve, ne ju kemi drejtuar me një kërkesë agjensionit pyjor të Kosovës, po ashtu e kemi ftuar që kryeshefin e këtij agjensionit që t vizitoj Rahovecin, ai ka qenë e ka vizituar, ku e kemi diskutuar punën sa i takon pronës për ndarje për krijimin e zonës ekonomike apo të turizmit. Kërkesa ju ka shkuar edhe qeverisë së Kosovës, ne kemi një përgjigje dhe shpresojmë se kërkesa e Komunës së Rahovecit për ndarje të kësaj prone në takimet e radhës së qeverisë së Kosovës do të miratohet dhe do të jepet viza Komunës së Rahovecit për këtë sipërfaqe prej 36 hektarësh në pjesën e Apterushës dhe zona e turizmit me një sipërfaqe prej 7 hektarësh në dalje të Rahovecit rrugës për Malishevë. Sa i takon pyetjes së z. Dervish Çadrakut për atë aparaturë e cila është blerë nëse nuk gaboj kur ka qenë ai drejtori i administratës. Kjo pajisje sa kemi qenë ne në mandatin e parë ka qenë funksionale, më vonë nuk e di pse nuk ka qenë funksionale, më kujtohet kur z. Fehim Fetoshi në atë kohë si kuvendar thoshte se kur kemi ardhur ne në komunë, në atë kohë ishte drejtor i administratës z. Lenhard Hamza, një djalë që i njeh shumë gjuhë të huaja, po ashtu dinë të punoj shumë mirë me kompjuter, ishte një lloj IT ndersa Fehim Fetoshi thoshte se drejtori i administratës nuk e dinë se për çka shërben kjo pajisje. Dallimi në mes z. Lenhard Hamzes dhe z. Fehim Fetoshit është si nata me ditën. I nderuar z. Çadraku kjo pajisje ekziston por ka një kosto shumë të madhe sepse ajo shërben vetëm për nxjerrjen e numrit rendor, një rodhne kushton diku 80.00 €, ne mundemi që ta funksionalizojmë por kostoja është shumë e madhe dhe kjo nuk gjendet në Kosovë. Pastaj mendoj se shërbimi përmes kioskes do të jetë shumë më i mirë dhe shumë më efikas ndaj qytetarëve, apo ndarja e veçantë e një sporteli për mërgimtar në mënyrë që ti kryejmë shërbime bashkatdhetarëve tanë vetëm për punët e tyre. Sa i përket objekteve shëndetësore është e vërtet që ka shumë objekte shëndetësore, po ashtu është e vërtet që disa prej tyre nuk janë funksionale, e gjitha kjo është për shkak të mungesës së stafit mjekësor, është fatkeqësi për komunën e Rahovecit që nuk ka mjekë, po ashtu është një disproporcion është në mes numrit të banorëve dhe stafit mjekësor që ka komuna jonë. P.sh komuna e Drenasit ka mjekë ashtu siç është edhe me ligj e ka stafin mjekësor për kokë banori aq sa duhet, ne kemi diku 36 staf mjekësor më pak se që i kemi numrin e banorëve. Ne ju kemi drejtuar qeverisë së Republikës së Kosovës, ministrisë së financave, për rritje të këtij stafi në bazë të numri të popullsisë, sa do të hasë kjo kërkesë në mirëkuptim do të shohim.

**Rasim Fazliu** – Kishte me qenë mirë që nënkryetari të na jepe pak sqarime shtesë rreth inkasimit të mbeturinave, e ceku se do të bëhet një sportel i veçantë për inkasim të mbeturinave, e nderuara znj. Florije e ceku se një herë duhet që të përzgjidhet operatori ekonomik e pastaj të bëhet inkasimi i mjeteve nga komuna. Pyetje ime është cila do të bëhet e parë hapja e sportelit apo do të bëhet përzgjedhja e operatorit i cili do e bëjë grumbullimin e mbeturinave, mendoj se nëse hapet sporteli së pari atëherë do të bëhet inkasimi i mbeturinave nga të dyja anët edhe nga komuna edhe nga operatori. Pra a ka plan të veprimt se çka do të bëhet konkretisht.

**Përparim Krasniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne do të marrim modelin e Prizrenit, pesë ekspertë japonez do të vinë vitin e ardhshëm për çështje të mbeturinave, plani është se një herë duhet që të krijohet një data bazë për të cilin nuk kemi planifikim, prandaj ne mendojmë se kishte me qenë mirë që të i presim deri në vitin e ardhshëm këta japonezë sepse modeli i Prizrenit është shumë i aplikueshëm për të gjitha komunat e Kosovës, prandaj mendojmë se vitin e ardhshëm ne të startojmë së bashku me këta pesë ekspertë japonez. Këtë vite ne i kemi disa plane që të bëjmë një data bazë ku do të jetë pjesë e MF, po ashtu duhet që të kërkohet edhe një pëlqim nga MF për kodin për të cilin duhet ata të lejojnë sikurse që është kodi i tatimit në

pronë, pa na dhënë ata këtë kod ne asgjë nuk mundemi të bëjmë, kjo është hapi i parë që duhet të ndërmerret nga komuna, kurse hapat e tjera do të vazhdojnë vitin e ardhshëm dhe do të shohim se si do na ecë pastaj puna.

**Kryesuesi** - E qes në votim Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Rahovecit 2019 – 2021: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e dytë (2) e rendit të ditës. Të nderuar kuvendarë për pikën e tretë dhe të katërt duhet që të jetë prezent nënkryetari i komunës i cili duhet që ti prezantoj këto dy pika, por për momentin ai është ende në takim me Ministrin e Bujqësisë të Republikës së Kosovës.

**Florije Boshnjaku** – I nderuari kryesues mendoj se për pikën e tretë të rendit të ditës ne duhet që të marrim vendim vetëm që të dele në debat publik,, por kishte me qen mirë që këto dy pika të diskutohen në fund të mbledhjes pasi të vijë nënkryetari.

**Kryesuesi** – Ju faleminderit për mirëkuptim, kalojmë atëherë në pikën e pestë (5) të rendit të ditës:

#### **5. Shqyrtimi i propozim Vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm pjesën e parcelës**

**P-71513005-00524-4, në fshatin Krushë e Madhe.**

**Afrim Oruçi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë ka pranuar një kërkesë nga OVL-ja e UÇK-së , në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, ku kanë kërkuar nga ne që të i evidentojmë të gjitha pronat si ato komunale, private dhe ato që janë në administrim të agjensionit pyjor, ne kemi përgatitu dy materiale, tani kemi të bëjmë me materialin për fshatin Krushë e Madhe, kjo është pronë komunale e Rahovecit, në këtë parcelë është lapidari i ngritur i dëshmorëve “Bekim Gashi” dhe “Dalip Behra”, ne i kemi inqizuar, këtë pronë e cila ka një sipërfaqe prej 153 m<sup>2</sup>, po ashtu në këtë pjesë më herët është shpallur një parcelë me interes të përgjithshëm, për ngritjen e palestrës sportive. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm të kësaj zone është : Që të ruhet parcela, të mirëmbahet dhe të shtohet kujdesi ndaj tyre që mos të vije deri tek ridestinimi apo ri pozicionimi i vendeve ku janë vendpreshjet e dëshmorëve. Ju ftoj që propozim vendimin e Kryetarit ta përkrahni.

**Florida Bajraktari** – Ne pajtohemi që të shpallet kjo parcelë interes i përgjithshëm, pasi që destinimi i tyre është ruajtja dhe mirëmbajtja e vendit të rrënjës së dëshmorëve të kombit “Bekim Gashi dhe “Dalip Behra”.

**Florije Boshnjaku** – Inicimi i kësaj procedura nga OVL-ja është me vend, po ashtu jam e mendimit që ne duhet që ta përkrahim. Po ashtu tek pika e katër duhet që të përmirësohet një gabim teknik sepse shënon për zbatimin e këtij propozim vendimi duhet të kujdeset drejtoria për Gjeodezi, kadastër dhe pronë, pasi është vendim duhet që të jetë vendim e jo propozim .

**Dervish Çadraku** – Ruajtja, rregullimi dhe mirëmbajtja e vendit të rrënjës së dëshmorëve ka shumë rëndësi, prandaj ne jemi të pajtimit për këtë propozim, po ashtu nëse ka edhe tjera propozime të këtij lloji është mirë që të kujdesemi sepse me të vërtet janë në një gjendje të mjerueshme dhe krijohet me të vërtet një përshtypje shumë e keqe nga njerëzit që kalojnë nëpër këto vende.

**Fehmi Cena** - Sigurisht që edhe ne jemi që të shpallet interesi i përgjithshëm kjo pjesë, besoj se edhe në të ardhmen do të kemi edhe shumë raste të tjera, sepse kemi shumë lapidare të dëshmorëve në Komunën tonë që nuk e kanë të zgjidhur këtë çështje. Është shumë e rëndësishme që vendet e lapidarëve të mos jenë pengesë e ndonjë objekti i cili gjithashtu është në interes të përgjithshëm, siç e kemi tani këtë rast.

**Kryesuesi** – E qes në votim Propozim vendimin për shpalljen e interesit të përgjithshëm pjesën e parcelës P-71513005-00524-4, në fshatin Krushë e Madhe: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e pestë(5) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

#### **6. Shqyrtimi i propozim Vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm pjesën e parcelës**

**P-71510056-00034-0, në fshatin Opterushë.**

**Afrim Oruçi** – Po ashtu edhe për këtë pikë Drejtoria për Gjeodezi, kadastër dhe pronë ka pranuar një kërkesë nga OVL-ja e UÇK-së , në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, këtu kemi të bëjmë me parcelën ku kanë rënë dëshmorë “Xhelal Hajda – Toni”, “Selajdin Mullabazi – Mici”, “Hamdi Hajrizi”, “Bektesh Haliti”, “Nezir Ymeri”. Kjo parcelë është pronë komunale shtetërore e Komunës së Rahovecit, por është në menaxhim të agjensionit pyjor të Republikës së Kosovës. Ne këtë parcelë e kemi inqizuar dhe është në një sipërfaqe prej 60 ari, qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm të kësaj parcele është: Mirëmbajtja, kujdesi, ri-rregullimi dhe ruajtja e këtyre vendeve, kjo është vetëm fillimi, fillimisht do të i identifikojmë vendet që janë prona komunale dhe të agjensionit, pastaj kemi shumë vende që janë prona private, por ne do i përgatisim nga 2-3 pika për çdo mbledhje dhe besoj se për disa vite do i regjistrojmë të gjitha. Në ato vende

ku kemi pengesa si tek Radoniqi në Rahovec, ato do të tërhiqen mbrapa dhe do të bëhet lirimi i trotuarit, kjo do të bëhet bashkërisht me ju. Ju ftoj që këtë propozim vendimin e Kryetarit ta përkrahni.

**Rasim Fazliu** – Edhe kjo pikë ne jemi pro që të shpallet interes i përgjithshëm për mirëmbajtjen, kujdesin, rregullimin dhe ruajtjen vendit ku kanë rënë dëshmorët “Xhelal Hajda – Toni”, “Selajdin Mullabazi – Mici”, “Hamdi Hajrizi”, “Bektesh Haliti”, “Nezir Ymeri”.

**Kryesuesi** – E qes në votim propozim Vendimin për shpalljen e interesit të përgjithshëm pjesën e parcelës P-71510056-00034-0, në fshatin Opterushë: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e gjashtë (6) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

#### **7. Shqyrtimi i propozim Vendimit për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokalë.**

Ky këshill duhet që të përbëhet nga tre anëtar nga radhët e Kuvendit, dy nga ekzekutivi, një anëtar nga shoqëria civile dhe një përfaqësues i fshatit, vendbanimit ose lagjes urbane.

**Rasim Fazliu** – Do të bëhet tani edhe unë juristë, ne e kemi vendimin para vete, kurse në rend dite është propozim vendim për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokalë, mendoj se duhet të jetë propozim vendime jo vendim. Ne në KPF nuk mundemi tani të japim ndonjë emër, por jemi të pajtimit që kjo pikë të kalojë për kuvend dhe pastaj në kuvend grupet politike do të konsultohen mes vete dhe do të propozojnë nga një emër, pastaj është në dorën e kuvendit se cilat propozime do të kalojnë. Në mandatin e kaluar kam qenë kryetari i këtij komisioni, besoni se është një punë shumë e madhe, me shumë përgjegjësi dhe një punë e cila donë shumë kohë. Po ju tregoj se vetëm në fshatin Ratkoc mbledhja ka zgjatur nga ora 18:00 deri në ora 24:00, prandaj i propozoj të gjitha grupeve politike që janë kuvend, që ti propozojnë me të vërtet kandidatët të cilët kanë kohë dhe njohuri sepse është një punë shumë me përgjegjësi. Ne e kemi edhe rregulloren për zgjedhjen e këshillave lokal, fshatrave dhe lagjeve urbane, por nuk e di a vlen ende kjo rregullore. Po ashtu desha të bëjë një pyetje, në mandatin e kaluar na ka përcjellë DEMOSI, a do të jetë edhe tani pjesë e këtij komisioni apo jo. Pastaj tek pika 1.3 e këtij vendimi ceket: Të verifikohet a është bërë aplikimi nga kandidat brenda afatit kohorë, nuk jam duke e kuptuar këtë pikë, sepse herën e kaluar ne kur kemi shkuar në fshatra, propozimet kanë ardhur drejtpërdrejt nga banorët dhe kanë qenë shumë transparente dhe shumë reale, mendoj se kjo pikë duhet të diskutohet ose të hiqet.

**Florije Boshnjaku** – Ky vendim së pari ka disa gabime teknike, ndoshta për dikë është asgjë kurse për mua si juriste ka shumë domethënie, në hyrje shkruan Kryetari i Komunës, kurse në fund shkruan Kryesuesi i Kuvendit, kjo duhet të jetë në përputhje me atë kush është duke e propozuar. Pastaj tek neni 1 dhe 2 ka gabime është mirë që kur të na vije në kuvend ta bën i përmirësimin. Tek neni 1.7 duhet të jetë: Përfaqësuesi i fshatit, qytetit dhe lagjeve urbane, e jo siç e keni cekur i vendbanimit sepse vendbanime është edhe fshati edhe qytetit, po ashtu edhe tek neni 2 është një gabim teknik sepse ceket: Të verifikohet a është bërë aplikimi nga kandidatët brenda afatit kohorë, këtë e ceku edhe z. Rasim Fazliu, nëse thuhet kështu atëherë ne duhet që të bëjmë thirrje publike, mendoj se kjo pikë duhet të hiqet. DEMOSI herën e kaluar i ka paguar disa të rijnë ku kanë shkuar nëpër vendbanime dhe i kanë njoftuar banorët se në këtë ditë mbahet takimi me komisionin për zgjedhjen e kryetarëve të fshatit ose lagjeve urbane, nëse bëhet njoftimi vetëm përmes zyrës për informim shumë qytetarë nuk do të kenë informatë. Pastaj herën e parë nuk kemi mundur që të zbatojmë kuotën gjinore, me rregullore sa e di unë duhet që të jetë 30% e kuotës femra, mendoj se drejtori i DKA-së kishte me qenë mirë që të mbajte takime me drejtorë të shkollave dhe ti njoftojë ato mësimdhënëse që është mirë që të jenë pjesë e këtyre këshillave lokalë. Pastaj kishte me qenë mirë që të shikohet mundësia e pagesës kryetarëve të këshillave lokale, nëse kërkon përgjegjësi atëherë duhet që të paguash, ne i falënderojmë që kanë punuar deri më tani në mënyrë vullnetare, ne në kuvend do e japim prapë kontributin tonë.

**Fehmi Cena** – Është hera e parë që jam duke u njoftuar me këto këshilla dhe me komisionin për zgjedhjen e këshillave lokal, por pas disa sqarimeve e kuptova procedurën, propozimi imë është që kjo pikë të kalojë në kuvend, po ashtu propozimi imë tjetër është që për kuvend të na vijnë emrat e anëtarëve të ekzekutivit. Në mënyrë që një pjesë e punës të kryhet dhe ne në kuvend të merremi me pjesën që na takon neve. Përndryshe se si do të funksionoj ky komision qenka edhe rregullorja dhe mendoj se ata duhet që të veprojnë përmes rregullores. Nëse ata kanë pengesa rreth organizimit, rreth njoftimit, rreth pagesave, atëherë ata mundën të dalin me një kërkesë në kuvend që të na njoftojnë dhe ne pastaj do të marrim ndonjë propozim në të ardhmen, për kryetarët e këshillave. Po ashtu edhe unë jam i mendimit që ata duhet të kenë një lloje pagese simbolike.

**Kryesuesi** – E qes në votim propozim Vendimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokalë: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e shtatë (7) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

#### 8. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndihmë financiare z. Bajram Popaj.

Neve na ka ardhur një kërkesë për ndihmë nga z. Bajram Popaj, i cili është duke u trajtuar me një sëmundje të rëndë siç është kanceri dhe nga ne kërkon që të i dalim në ndihmë.

**Rasim Fazliu** – Ne kemi pasur raste edhe më parë ku i kemi dalë në ndihmë qytetarëve të Komunës së Rahovecit për shkaqe shëndetësore, mendoj se edhe kësaj radhe duhet që ti dalim në ndihmë z. Bajram Popaj, për shumë arsye dhe njëra prej arsyeve është sepse ai është së pari një çlirimtar i yni i cili ka bërë shumë për lirinë që ne gëzojmë ne sot. E mbështes propozimin e Kryetarit të Komunës që ti ndahet shuma prej 3,000.00 €, mendoj se Kryetari i Komunës dhe drejtori për financa e dinë më mirë se ne, se sa janë mundësitë për ti dalë në ndihmë, unë mundem të them tani që të ndahet ma shumë mjete pasi e ka një sëmundje të ndërlikuar, por prapë po e them Kryetari dhe Drejtori e dinë më së mirë dhe nëse ata kanë mundësi atëherë kishte me qenë mirë që të ritet shuma për ndihmë financiare z. Bajram Popaj.

**Florije Boshnjaku** – Po ashtu edhe unë plotësisht jam e pajtimit me diskutimin e z. Rasim Fazliu, ne edhe më herët sa herë që na kanë ardhur kësi lloje kërkesash, më mirë se Kryetari i Komunës dhe drejtori i financave askush nuk e dinë gjendjen financiare të Komunës, ne mundemi tani këtu të bëjmë politik dhe të propozojmë shumën prej 10,000. €, por mundësitë e dinë më mirë Kryetari. Këtë rast e kemi edhe të afërt familjar dhe kam emocione sepse më vije shumë keq që po i ndodhë kjo duke e ditur se si e ka pasur ai rastin në familje, po ashtu duke e ditur edhe kontributin e tij për lirinë e këtij vendi. Propozimi imë është nëse Kryetari i Komunës ka mundësi që ti ndajë më shumë mjete kishte me qenë mirë por nëse jo atëherë pajtohemi me shumën e propozuar nga Kryetari i Komunës.

**Fehmi Cena** – Po ashtu edhe ne nuk jemi kundër, qytetarët tanë kur kanë nevojë për mjekim nga disa sëmundje të rënda që kanë kosto, ka disa sëmundje që kërkojnë edhe shërim jashtë vendit po ashtu kanë kosto të madhe dhe është mirë që ti dilet në ndihmë. Por kishte me qenë mirë që kur të na vije kërkesa në kuvend të jetë pak më e plotësuar si lëndë, pos kërkesës së të jetë edhe një dokument mjekësor me diagnoza etj. Nuk jam duke e kontestuar këtë rast sepse edhe parafolësit edhe unë e njoh shumë mirë të nderuarin, për të cilin nuk e kam ditur se e ka këtë sëmundje. Për këto raste qytetarët duhet që të njoftohen dhe të drejtohen edhe në Ministrinë e Shëndetësisë sepse ekziston edhe një fond pranë kësaj ministrie për ato raste që kanë nevojë për mjekim jashtë vendit, nëse ka nevojë edhe Komuna le të intervenoj në ministri që të i dilet ndihmë shtesë edhe nga ai pozicion.


**Kryesuesi** – I nderuari z. Cena mbrapa kërkesës e ka pjesën e diagnozës dhe të dhënave të tjera që i ka pasur nga mjeku. Nëse nuk ka askush të diskutoj rreth kësaj pike, e qes në votim Propozim vendimin për ndihmë financiare z. Bajram Popaj: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e tetë (8) e rendit të ditës. Siç po duket nënkryetari do të vonohet dhe ne kemi mbetur pa i shqyrtuar edhe dy pika që i lamë për fund.

**Rasim Fazliu** – I nderuari kryesues në emër të gjithë anëtarëve të KPF-së propozoj që këto dy pika të kalojnë për kuvend, ku pastaj në kuvend do i diskutojmë më gjerësisht.

**Kryesuesi** – Faleminderit i nderuari z. Fazliu, atëherë e qes në votim propozimin e z. Rasim Fazliu që pika e tretë (3) dhe e katërt (4), të kalojnë për shqyrtim në Kuvend: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar propozimi i z. Rasim Fazliu. Ju falënderoj për kontributin e dhënë sot, shihemi në takimet e radhës.

Mbledhja ka përfunduar në ora: 12:10

Procesmbajtësi,

  
Skender Hamza



KRYESUESI

  
Afim Dina